REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA
KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
Nr.Br.No. 01 / 587
07. 11. 2019
PRISHTINË

KGJK. Nr. 226 /2019
Datë: 6 nëntor 2019

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 104 dhe 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 pika 1.12, 1.14 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Ligjin Nr. 06/L-054 për Gjykatat, Rregulloren (01/2014) për procedurën e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve (të ndryshuar dhe plotësuar), nenit 5 të Shtojces së Rregullorës për Organizimin e Brendshëm të Gjykatave, si dhe Ligjit NR.04/L-199 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Parë Ndërkombëtare të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, në mbledhjen e 226-të, të mbajtur me datë 6 nëntor 2019, merr këtë:

V E N D I M

I. Të shpallet konkurs i brendshëm për një (1) pozitë të lirë për Gjyqtar nga komuniteti serb, në Gjykatën e Apelit-Divizioni në Mitrovicë.

II. Obligohet Sekretariati i KGJK-së që të publikoj konkursin në Ueb faqen e KGJK-së, si dhe të vendoset në tabelat e shpalljeve të gjykatave.

III. Vendimi hyn në fuqi me datë 6 nëntor 2019.

A r s y e t i m

Gjykata e Apelit-Divizioni në Mitrovicë, bazuar në Shtojcën e Rregullorës për Organizimin e Brendshëm të Gjykatave përkatësisht në nenin 5 (Organizimi i Divizionit), përbëhet prej shtatë (7) gjyqtarëve, prej të cilëve pesë (5) gjyqtarë nga komuniteti serb dhe dy (2) nga komuniteti shqiptar.

Meqë në muajin tetor/2019 një (1) gjyqtar i komunitetit serb nga Divizioni i Apelit, ka arritur moshën e pensionimit, si rrjedhojë e kësaj në Gjykatën e Apelit-Divizioni në Mitrovicë, është një (1) pozitë e lirë për gjyqtar nga rradhët e komunitetit serb.

KGJK, në takimin e mbajtur me datë 6 nëntor 2019, me qëllim të funksionimit në përbërje të plotë të këtij Divizioni, vendosi të shpall konkurs të brendshëm për një (1) pozitë, nga rradhët e gjyqtarëve nga komuniteti serb.

Andaj, nga ajo që u tha si me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Skender ÇOÇAJ,

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- *Gjykatës së Apelit-Divizioni në Mitrovicë dhe Gjykatave Themelore;*
- *Sekretariatit të KGJK-së;*
- *Arkivit.*